



Ligji 109/2020 Datë 29.07.2020

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 4/2020, “PËR SHKËMBIMIN AUTOMATIK TË INFORMACIONIT TË LLOGARIVE FINANCIARE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr. 4/2020, “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 11 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“2. Përgjashtimisht për shkëmbimin e pare automatik, autoriteti kompetent shkëmben informacion me juridiksionet e tjera kompetente brenda datës 31.12.2020.”.

Neni 2

Pika 1 e nenit 19 ndryshohet si më poshtë:

“1. Përgjashtimisht për raportimin e parë, institucioni financiar raportues, pas aplikimit të procedurave të vigjilencës së duhur, raporton brenda datës 15 nëntor 2020 për të gjitha llogaritë e raportueshme ekzistuese në datën 1.1.2019, si dhe llogaritë e raportueshme të hapura përgjatë vitit 2019, sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji.”.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 29.7.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11583, datë 5.8.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

Botuar ne F.Zyrtare 146/2020

Dale nga shtypi 07.08.2020